



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNAE KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA - OPŠTINA KUNA
www.komurKi-kline.org



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Klinë shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të Ekonomisë
Institucioni	Komuna Klinë
Nr. i Referencës	RN00012167
Kodi	RPC0005744
Data e njoftimit	26.07.2023
Afati për aplikim	17.08.2023 - 24.08.2023



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Bënë përcjelljen e çmimeve të artikujve, dhënies së paragon – bllokut dhe faturës të tregtisë me shumicë dhe pakicë;
- Bënë përcjelljen e orarit të punës së bizneseve afariste;
- Përcjellë të dhënat mbi saktësinë e prejardhjes së mallit, përcjellë zhigosjen e peshoreve;
- Mbikëqyrë mallin me defekte teknike, bënë kontrollimin e librave tregtarë të shitjes dhe blerjes;
- Obligon të gjitha subjektet afariste të vendosin mbishkrimin e firmës në lokalet e tyre afariste;
- Përcjellë subjektet afariste, të cilat sillen në mënyrë monopoliste si dhe konkurrencën jo lojale në tregti;
- Bënë konfiskimin e mallit në bazë të rregullores mbi tregtinë dhe atë: kur malli është pa dokumentacion përcjellës, pa faturë, pa fletëdërgesë ose paragon-blok, pa numër të regjistrimit të biznesit të blerësit dhe shitësit, mos regjistrimi i faturës në librat e tregtisë dhe kur subjekti afarist nuk ka leje pune;
- Merrë masa ndaj subjekteve afariste të cilat bëjnë spekulim me mallra në tregtinë të cilat ndikojnë në çrregullimin e furnizimit të qytetarëve me artikuj të konsumit të gjerë;
- Aplikon të gjitha masat ndëshkuese të cilat janë të parapara me ligj dhe akte tjera nënligjore;
- Inkason mjetet nga dënimet e shqiptuara në vendin e ngjarjes;
- Ushtron fletëparaqitje për shkeljen e dispozitave me të cilat bëhet kundërvajtje ;
- Kryen detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

2. Kërkesat e përgjithshme për praninë

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimitimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve të fushës ekonomike.
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit të fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.



5. Pozitat aktualisht të lira

Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës	Nr. i kërkuar
RPC0005502	RN00011908	Inspektor i Tregut	Profesional 1	Gj21-6.52	Komuna Klinë	Drejtoria e Inspektoratit / Kline	1

6. Mënyra e aplikimit

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit;
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- Dëshmia nga Gjykata që nuk është nën hetime.

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë

9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

- Njohuri lidhur me vendin e punës, aftësi të përgjithshme, aftësi logjike.

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:



Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.
Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk prahen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

